



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/148 Nr. i faq./Br.str./No.pg 88
Data/Datum/Date 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), neneve 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i dt. 29.03.2017, vendimit për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034" të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Nr. Prot. 2917-2/26 të datës 25.05.2026, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.05.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të planifikimit hapësinor "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034"

Neni 1

Me këtë vendim hapet shqyrtimi publik i draft dokumentit të planifikimit hapësinor "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034".

Neni 2

Qëllimi i këtij vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të planifikimit hapësinor "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034" sipas nenit 1 të këtij vendimi është që dokumenti të jetë i hapur për publikun, ku ftohen qytetarët, ekspertët dhe palët e interesit për të paraashtruar komentet apo sugjerimet, para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor - Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034.

Autoriteti i planifikimit, përkatësisht Komuna e Rahovecit siguron dhe inkurajon pjesëmarrjen publike transparente në procesin e planifikimit, duke ofruar qasje publike në çdo fushë të zhvillimit hapësinor në tërë territorin e Komunës së Rahovecit të planifikuar në këtë dokument, në të dhëna, harta, grafikone dhe çdo kërkesë që parashtrojnë palët e interesit lidhur me këtë dokument.

- 2.1. Ekspozimi i draft dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034" bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.
- 2.2. Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën mbahen prezantimet shtesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.
- 2.3. Për të gjitha prezantimet publike mbahet procesverbali.
- 2.4. Shqyrtimi publik i draft dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034" zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të planifikuara me ligj.
- 2.5. Shpallja e shqyrtimit publik të draft dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034" bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe mediat televizive publike dhe lokale.

2.6. Draft dokumenti “Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034” do të jetë i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 3

3.1. Ky draft dokument do ti nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

3.2. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 4

Shqyrtimi i draft dokumentit “Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034” do të organizohet nga Komuna e Rahovecit në suaza të kompetencave të përcaktuara me ligj.

Neni 5

5.1. Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të draft dokumentit “Harta Zonale e Komunës së Rahovecit 2026-2034”.

5.2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

Neni 6

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.

Neni 7

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.148/26

Me datë: 29.05.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit